


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2024**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet, që kanë për detyrë realizimin e reformës në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian;

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2024 në drejtim të:

Mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike të 34 subjekteve me tipologji të ndryshme të institucioneve në shërbimin civil.

Realizimit të mbikëqyrjes së skemës së funksionimit të shërbimit civil gjatë procesit të miratimit të strukturës së institucioneve të administratës vendore.

Realizimit të mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e informacionit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Mbikëqyrjes së orientuar nëpërmjet monitorimit online dhe në subjekt në lidhje me rekrutimet e realizuara nga Departamenti i Administratës Publike.

Monitorimit të proceseve të rekrutimit në administratën vendore, me qëllim parandalimin e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

Trajtimin të 95% të informacioneve/kërkesave/sinjalizimeve, që kanë ardhur për shqyrtim në drejtim të Komisionerit brenda vitit 2024.

Kuvendi kërkon që Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të intensifikohen inspektimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke u dhënë përparësi atyre me shkelje të përsëritura të procedurave të shërbimit civil.

2. Të zhvillohen mekanizma për monitorim të vazhdueshëm dhe në kohë reale për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në nivel vendor.

3. Me qëllim përmirësimit të transparencës dhe komunikimit publik, KMSHC-ja të zhvillojë platformat digjitale për raportim dhe ankim nga nëpunësit civilë dhe qytetarët për shkelje të procedurave.

4. Në bashkëpunim të ngushtë me DAP-in, të intensifikojë angazhimin në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore për rikthim në detyrë të nëpunësve civilë.

5. Të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2025 dhe të informojë Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike për gjetjet e këtij monitorimi.

6. Të investohet në hartimin e një raporti vjetor me listimin e institucioneve me shkelje të përsëritura dhe propozime për ndërhyrje nga institucionet mbikëqyrëse.

7. Të angazhohet në hartimin e një raporti analitik në lidhje me kostot financiare për buxhetin e shtetit në rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, si dhe në lidhje me vendimet gjyqësore të paekzekutuara.

Miratuar në datën 30.10.2025

Këshilltare: Besi Londo

Drejtoresh e Shërbimit të Monitorimit: Aurela Bicja

Drejtoresh e Shërbimit Juridik: Mimoza Arbi